# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6886
E enjte, 4 maj 2023
Çmimi 0.40 €


## Ulen çmimet e roaming-ut mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


QEVERIA E KOSOVËS KA LIRUAR NGA DETYRA EKIPIN MENAXHUES TË HARTIMIT TË DRAFT-STATUTIT TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE FAQE 4-5

# SHKARKIMI I EKIPIT MENAXHUES TË ASOCIACIONIT, I VONUAR DHE PROPAGANDË QEVERITARE



Pa kaluar as 24 orë nga prezantimi i draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Bruksel, Qeveria e Kosovës ka shkarkuar nga detyra Ekipin Menaxhues i cili ka hartuar këtë statut, por që është refuzuar nga kryeministri Albin Kurti. Një veprim i tillë i qeverisë Kurti nga njohësit e rrethanave politike është vlerësuar propagandë qeveritare. Ata kanë thënë se ekipi menaxhues është dashur të lirohet nga detyra më herët dhe jo të lejohet të paraqesë dokumente të dëmshme të cilat do të shërbejnë si bazë në dialog. Ndërsa kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e ka quajtur të drejtë vendimin për shkarkimin e Ekipit Menaxhues

## AGK-ja, thirrje prokurorëve dhe gjyqtarëve t'i trajtojnë me prioritet rastet e dhunës ndaj gazetarëve

FAQE 7



## KDI-ja: Ku janë inspektorët e 'premtuar' të punës

FAQE 8




## AKTUALE



### SHBA-ja do të dërgojë 300 milionë dollarë armë në Ukrainë F. 2

### Tetë nxënës dhe një rojë vriten nga të shtënat në një shkollë në Beograd F. 2

### Gjykata Speciale bastisi të martën dy shtëpi në Prishtinë, KMDLNJ jep detaje F. 3

## EKONOMI



### Nënshkruhen dy marrëveshje për subvencionimin e Trepçës me 1.87 milion euro F. 8

### Rritet në 7 për qind inflacioni në Eurozonë F. 8

## SPORT



### Tri fitore nga skuadrat vendase F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# ShBA-ja do të dërgojë në Ukrainë armë në vlerë 300 milionë dollarë

UASHINGTON, 3 MAJ - Shtetet e Bashkuara do t'i dërgojnë Ukrainës rreth 300 milionë dollarë ndihmë ushtarake në kohën kur luftëtarët ukrainas po përgatiten për një ofensivë pranverore kundër ushtrisë pushtuese ruse. Njoftimi zyrtar për ndihmën pritet të bëhet gjatë ditës së sotme, thanë zyrtarët amerikanë.
Paketa do të përfshijë fishekë për artileri, obusë, raketa për sistemin Himars, mortaja dhe pushkë antitank.
Për herë të parë ShBA-ja do të dërgojë edhe raketa Hydra-70, të cilat lëshohen nga avionët dhe mund të përdoren si mbështetje nga ajri për avancimin e forcave tokësore të Ukrainës.
Armët do të nxirren nga stoqet e Pentagonit.
Kjo do të jetë dërgesa e 37-të e armëve nga ShBA-ja në Ukrainë prej se Rusia ka nisur pushtimin e fqinjës të saj në shkurt të vitit 2022.
Perëndimi e ka ndihmuar vazhdimisht Ukrainën me armatim, ndërsa kundër Rusisë ka ndërmarrë sanksione të ashpra.
Aktualisht luftimet janë të përqendruara në lindje të Ukrainës, sidomos në qytetin e Bahmutit.
Shtëpia e Bardhë vlerësoi këtë javë se 20 000 luftëtarë rusë janë vrarë në Ukrainën lindore që nga dhjetori.
Zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, John Kirby, tha se pothuajse gjysma e tyre ishin pjesëtarë të grupit mercenar Wagner.
Kreu i Wagnerit, Yevgeny Prigozhin, tha se luftëtarët e tij nuk po marrin furnizimet që u nevojiten për shkak të mungesës së mbështetjes nga Moska.




# Zelensky viziton Finlandën për takime me udhëheqësit nordikë



HELSINKI, 3 MAJ - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka bërë një vizitë të paparalajmëruar në Finlandë, të mërkurën, për të marrë pjesë në një samit të udhëheqësve të pesë vendeve nordike, ka njoftuar Presidenca finlandeze.
Zelensky është takuar në Helsinki me presidentin finlandez Sauli Niinisto, vendi i të cilit u bë anëtari më i ri i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), në prill, për të diskutuar për "luftën e Ukrainës për mbrojtje", raporton AFP.
Udhëheqësi ukrainas do të zhvillojë, po ashtu, bisedime bilaterale me kryeministrin suedez Ulf Kristersson, me Jonas Gahr Storen e Norvegjisë, me Mette Fredriksenin e Danimarkës dhe me Katrin Jakobsdottirin e Islandës. "Për të hyrë në NATO dhe për t'i mbështetur aleancat, për të siguruar mbështetje, duhet të bëhet punë thelbësore diplomatike. Ukraina po e bën atë sot", ka shkruar këshilltarja për komunikime e Presidencës ukrainase, Daria Zarivna, në "Telegram".
Të gjitha vendet nordike janë zotuar se do t'i ofrojnë Ukrainës mbështetje financiare dhe ushtarake pas pushtimit nga Rusia në shkurtin e vitit 2022.
Suedia, Danimarka, Finlanda dhe Norvegjia i janë bashkuar, po ashtu, përpjekjes ndërkombëtare për ta furnizuar Ukrainën me armë të rënda, duke i dhuruar disa prej tankeve të tyre Leopard 2, apo duke ofruar mbështetje financiare për blerjen e tyre.

# Tetë nxënës dhe një roje vriten nga të shtënat në një shkollë në Beograd

Beograd, 3 maj - Tetë nxënës dhe një roje sigurie u vranë të mërkurën nga të shtënat me armë zjarri në Shkollën Fillore "Vladislav Ribnikar" në Beograd, bëri me dije Policia e Serbisë. Sipas njoftimit, gjashtë nxënës të tjerë dhe një mësues u plagosën dhe aktualisht ndodhen në trajtim mjekësor.
Në oborrin e shkollës u gjet dhe u arrestua nxënësi i kësaj shkolle, K. K. (14), i cili dyshohet se ka kryer këtë vepër tha, po ashtu, policia, pa dhënë detaje për motivin e sulmit.
Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë ka njoftuar se i dyshuari, nxënës i klasës së shtatë, ka qëlluar disa herë nga arma e të atit në drejtim të nxënësve dhe sigurimit të shkollës.
Millan Nedelkoviq, kryetar i komunës së Vraçarit ku ndodhet shkolla, u tha gazetarëve se nxënësi ka sjellë një armë në çantën e shpinës dhe se të shtënat kanë ndodhur në korridorin e shkollës.
Ai tha se shkolla ka kamera sigurie, por se nuk ka detektorë metalikë.
Gazetarët e REL-it në vendin e ngjarjes raportojnë se nxënësit janë evakuuar përmes hyrjes dytësore të shkollës.
Sindikata e Punëtorëve e Arsimit në Serbi tha se "tragjedia në shkollën fillore është dëshmi se jetojmë në kushte ekstreme dhune".




## OKB-ja: Bota të përgatitet për El Ninjon dhe temperatura të reja rekorde



GJENEVË, 3 MAJ - Agjencia Meteorologjike e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka paralajmëruar për rritjen e gjasave për zhvillimin e fenomenit të motit, El Ninjo, në muajt e ardhshëm, duke nxitur temperatura më të larta globale dhe, mbase, rekorde të reja nxehtësie.
Organizata Botërore Meteorologjike ka thënë të mërkurën se tani vlerëson që gjasat për zhvillimin e El Ninjos para fundit të korrikut qëndrojnë në 60 për qind, ndërsa para fundit të shtatorit në 80 për qind, raporton AFP.
"Kjo do t'i ndryshojë tendencat e motit dhe të klimës në mbarë botën", ka thënë Wilfran Moufouma Okia, shef i shërbimit për parashikimin e klimës në OBM.
El Ninjo, një fenomen që ndodh natyrshëm, dhe që shoqërohet zakonisht me rritje të nxehtësisë në mbarë botën, por edhe me thatësirë në disa pjesë të botës dhe me shira të rrëmbyeshëm në zona të tjera, për herë të fundit ka ndodhur më 2018-19.
Që nga viti 2020 bota është goditur nga e kundërta e ftohtë e El Ninjos, një La Ninja jashtëzakonisht e gjatë, e cila ka përfunduar më herët këtë vit, duke ua hapur rrugën kushteve aktuale neutrale.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Gjykata Speciale bastisi të martën dy shtëpi në Prishtinë, KMDLNj jep detaje

Prishtinë, 3 maj - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka dhënë detaje për bastisjen nga Gjykata Speciale të shtëpive të Flamur Sopit dhe Nuhi Ahmetit. “Sipas informatave të KMDLNj-së, mbrëmë, më 2 maj 2023, policë të Gjykatës Speciale - EULEX-it - bastisën shtëpinë e Flamur Sopit dhe Nuhi Ahmetit, duke filluar nga ora 19:00 e deri në mesnatë. Policë të Gjykatës Speciale mbrëmë midis orës 19:00 e deri më 23:00, bastisën shtëpinë ku banon me qira Nuhi Ahmeti, ish i burgosur politik, kontribuues aktiv në luftën e UÇK-së dhe nga viti 1990 aktivist i KMDLNj-së. Nuhi Ahmeti i ka deklaruar KMDLNj-së se policët para bastisjes ia kanë treguar urdhrin e Gjykatës për bastisje, e kanë njoftuar me të drejtat që i takojnë si dhe për të drejtën që gjatë bastisjes të jetë edhe avokati i autorizuar nga z. Ahmeti. Nuhi Ahmeti thotë se sjellja e policëve ishte në përputhje me mandatin e përcaktuar, se nuk kanë bërë asnjë dëm material dhe se ia kanë konfiskuar një telefon. Pas bastisjes i kanë lënë një ftesë për intervistim në EULEX, me datë 3 maj 2023, në orën 9:30”, ka njoftuar KMDLNj.
KMDLNj ka bërë me dije se është në pritje të përfundimit të intervistimit në mënyrë që t’i mësojë arsyet e bastisjes dhe qëllimet e intervistimit. “Gjatë bastisjes nuk ishte i pranishëm avokati shkaku se Nuhi Ahmeti nuk ka kërkuar praninë e avokatit, ndërsa gjatë intervistimit do të jetë i pranishëm avokati i autorizuar nga z. Nuhi Ahmeti”, ka njoftuar KMDLNj.



# Ulen çmimet e roaming-ut mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor

Prishtinë, 3 maj - Operatorët telefonikë nga Ballkani Perëndimor dhe nga vendet e Bashkimit Evropian kanë nënshkruar një marrëveshje për zvogëlimin e dallimeve ndërmjet çmimeve për shërbimet e telefonisë mobile brenda dhe jashtë vendit në të dy drejtimet, ka njoftuar Komisioni Evropian.
Marrëveshja vullnetare, e firmosur nga 38 operatorë nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor, pritet t’i shkurtojë shpenzimet për konsumatorët që udhëtojnë ndërmjet BE-së dhe rajonit, për të paktën një të tretën e çmimeve mesatare aktuale.
Kjo është një marrëveshje për të cilën u arrit pajtim në samitin mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, të mbajtur dhjetorin e kaluar në Tiranë.
Siç theksohet në njoftimin e KE-së, ulja e çmimeve nxit dhe thjeshtëzon shkëmbimet biznesore, kulturore, turistike dhe të tjera ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, duke forcuar lidhjet ndërmjet rajoneve fqinje. “Operatorët aktualisht po punojnë për krijimin e produkteve me çmime më të vogla se ato për të cilat u arrit pajtim, që do të jenë në dispozicion për blerje nga numri më i madh i mundshëm i konsumatorëve”, thuhet në njoftim.
Nënshkrimi i marrëveshjes për reduktimin e çmimeve të roaming-ut u mirëprit nga komisionari evropian për Zgjerim, Oliver Varhelyi. “Kjo marrëveshje vullnetare do t’i bëjë gjërat të parashikueshme, do të ndihmojë në eliminimin e befasive në faturat e konsumatorëve dhe do të mundësojë reduktime të ndjeshme të kostove të roaming-ut për konsumatorët nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor”, ka thënë komisionari Varhelyi.
Ky proces mbështetet edhe nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe nga Komisioni Evropian. KE-ja i ka ftuar edhe operatorët e tjerë telefonikë nga BE-ja dhe rajoni për t’iu bashkuar iniciativës.
Nga 1 korriku i vitit 2021 rajoni i Ballkanit Perëndimor është zonë ku nuk aplikohen tarifat e roaming-ut. Vizitorët paguajnë për thirrje, për porosi SMS dhe për qasje në internet me të njëjtin çmim si në vendin e tyre, nëse ndodhen në territorin e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.
Marrëveshja për roaming-un mes vendeve të Ballkanit Perëndimor është nënshkruar në prillin e vitit 2019, pas së cilës çmimet e thirrjeve telefonike janë reduktuar për rreth 27 për qind nga korriku i atij viti dhe i ka hapur rrugën heqjes së plotë të tarifave të roaming-ut nga korriku i vitit 2021.




## Ministri i Mbrojtjes, Mehaj: Zgjerimi i NATO-s është antidoda për të siguruar stabilitet



Prishtinë, 3 maj - Në një takim virtual me Komisionin e Përgjithshëm për Drejtësinë, Çështjet e Brendshme dhe Sigurinë e shteteve të Evropës Jug-lindore në Procesin e Bashkëpunimit ndërmjet këtyre shteteve, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka diskutuar mbi disa tema të rëndësishme të nxitura nga situata aktuale gjeopolitike dhe pushtimi i paprovokuar rus në Ukrainë, të cilat në mënyrë direkte kanë ndikuar në strategjitë e shteteve dhe format e bashkëpunimit, domosdoshmërinë e unitetit si formë e vetme e mbrojtjes së vlerave demokratike përballë shteteve autokrate me tendenca ekspanzioniste. “Duke qenë dëshmitarë të sulmeve të vazhdueshme ruse në Ukrainë dhe luftës hibride ruse me target Ballkanin, zgjerimi i NATO-s është antidoda për të siguruar stabilitet, që së bashku me investimet strategjike në fushën e mbrojtjes dhe zhvillimit të gjithëmbarshëm ekonomik, do të mundësojë zgjidhjen edhe të krizës së refugjatëve e ruajtjen e paqes ndërmjet kombeve. Në këtë aspekt Kosova mbetet e përkushtuar për përkrahjen e politikave perëndimore, aleancës ndërmjet shteteve dhe mbështetjen e partnerëve tanë strategjikë”, ka thënë Mehaj.



QEVERIA E KOSOVËS KA LIRUAR NGA DETYRA EKIPIN MENAXHUES TË HARTIMIT TË DRAFT-STATUTIT TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

# Shkarkimi i Ekipit Menaxhues të Asociacionit, i vonuar dhe propagandë qeveritare

Pa kaluar as 24 orë nga prezantimi i draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Bruksel, Qeveria e Kosovës ka shkarkuar nga detyra Ekipin Menaxhues i cili ka hartuar këtë statut, por që është refuzuar nga kryeministri Albin Kurti. Një veprim i tillë i qeverisë Kurti nga njohësit e rrethanave politike është vlerësuar propagandë qeveritare. Ata kanë thënë se ekipi menaxhues është dashur të lirohet nga detyra më herët dhe jo të lejohet të paraqesë dokumente të dëmshme të cilat do të shërbejnë si bazë në dialog. Ndërsa kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e ka quajtur të drejtë vendimin për shkarkimin e Ekipit Menaxhues

EPOKA E RE Lirim GECI

**Prishtinë, 3 maj** - Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë nuk janë pajtuar për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe i cili është paraqitur të martën nga Ekipi Menaxhues në kuadër të dialogut të Brukselit.

Kryeministri Albin Kurti para medieve në mbrëmjen e së martës ka deklaruar se ky draft-statut i Asociacionit është i papranueshëm. "Qartazi ekziston dëshira për Republika Srpska në Kosovë dhe kjo dëshirë është shkruar në këtë statut", ka thënë Kurti. Pa kaluar as 24 orë nga paraqitja e draft-statutit të Asociacionit, ministri i Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka shkarkuar nga detyra Ekipin Menaxhues i cili e ka hartuar këtë dokument. Krasniqi ka bërë me dije se vendimi i tij bazohet në marrëveshjet e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. "Pas prezantimit të djeshëm në Bruksel të draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, sipas përgjegjësive që i ishin dhënë Ekipit Menaxhues në marrëveshjet e Brukselit të vitit 2013 dhe 2015, ky ekip tash edhe vetë është pa status. Andaj, sot, me datë 03 maj 2023, kam marrë vendim për lirimin nga detyra të anëtarëve të këtij ekipi menaxhues, në përbërje të Danijela Vujiçiq, Jelena Bolovic, Igor Kalamar dhe Dejan Radojkoviq", ka njoftuar Krasniqi.

Pas këtij vendimi kanë ardhur reagimet nga Serbia në drejtim të kryeministrit Albin Kurti.

Kryengociatori serb në dialogun me Kosovën, Petar Petkoviq, ka thënë se vendimi për shkarkimin nga detyra të Ekipit Menaxhues është "i njëanshëm dhe i paligjshëm". Petkoviqi ka thënë se ky vendim "çon në shfuqizimin e asociacionit dhe dialogut". "Mandati i ekipit menaxhues nuk përfundon me prezantimin e draft-statutit të Asociacionit, por ekipi drejtues ka një rol të rëndësishëm në vetë procesin e formimit të Asociacionit deri në themelimin e tij", ka thënë Petkoviqi. Në këtë kontekst, ai ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, "e ka ndërprerë procesin e formimit të Asociacionit", kanë raportuar mediet serbe. "Tani mendoj se është e qartë për të gjithë se Kurti nuk dëshiron ta formojë Asociacionin dhe se dëshiron ta shmangë këtë obligim të rëndësishëm në çdo mënyrë", ka thënë ai, duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian që "ta ndalojë menjëherë paligjshmërinë e Kurtit. Me këto lëvizje të sforcuara Kurti tregon pa mëdyshje se nuk dëshiron as paqe e as dialog. Paligjshmëria e Albin Kurtit duhet të ndalet urgjentisht nga BE-ja, sepse shkarkimi i ekipit menaxhues çon në shfuqizimin e Asociacionit dhe rrjedhimisht edhe në shfuqizimin e procesit të dialogut", ka theksuar Petkoviqi.

## Kritika të shumta për shkarkimin e Ekipit Menaxhues

Vendimi i qeverisë Kurti për shkarkimin e Ekipit Menaxhues është komentuar në mënyra të ndryshme edhe nga përfaqësuesit e partive politike dhe njohësit e çështjeve politike në vend. Opinionisti Imer Mushkolaj ka shkruar në "Facebook" se ky ekip është dashur të shkarkohet më herët e jo pasi ka prodhuar një dokument të dëmshëm. Sipas tij, vendimi për shkarkimin e ekipit tash është i kotë dhe veç propagandë qeveritare. "Ekipi Menaxhues për hartimin e draft-statutit të Asociacionit, që e paska shkarkuar qeveria, edhe ashtu s'ka pasur tjetër punë. Ky ekip është dashur të shkarkohet më herët e jo pasi ka prodhuar një dokument të dëmshëm, që do të shërbejë si bazë për negociata. Vendimi për shkarkimin e ekipit tash është i kotë dhe veç propagandë qeveritare", ka shkruar Mushkolaj.

Edhe gazetari Adriatik Kelmendi ka theksuar se shumë mirë që u shkarkua Ekipi Menaxhues për Asociacionin por, sipas tij, ky shkarkim është i vonuar. “Dëmi i madh është bërë”, ka shkruar Kelmendi në “Facebook”. Kelmendi ka thënë se qeveria e ka ditur se kryesuesja e Ekipit është deputete e partisë së Vuçiqit në Kuvendin e Serbisë. “Nuk është dashur me asnjë kusht të lejohet prezantimi i një deputeteje e cila është betuar në Kushtetutën e Serbisë - Kushtetutë brenda së cilës ndodhet edhe Kosova - të propozojë çfarëdo për rregullimin e brendshëm të Kosovës. Është historike”, ka shkruar Kelmendi.

Ndërsa ish-zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Petrit Selimi, duke iu referuar zhvillimeve të fundit rreth draft-statutit të Asociacion të hartuar nga Ekipi Menaxhues, ka thënë se Kosova duhet ta ketë një dokument i cili bazohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ai ka treguar edhe rrezikun që tash Kosova mund të ketë një draft të Asociacionit të hartuar nga BE-ja dhe t'i ofrohet Kosovës si “kompromis” si marrëveshja e Ohrit. “Kosova kohë më parë është dashur të ketë një projekt-statut të bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Qeveria kishte disa vjet për t'u përgatitur për një propozim të saktë, konciz, që do të ishte konstruktiv dhe i bazuar në modele funksionale evropiane. Ne rrezikojmë tani që BE-ja të hartojë një ‘kompromis’ si Ohri”, ka shkruar Selmi në “Twitter”.

Ndërsa zyrtarja e lartë e Partisë Socialdemokrate (PSD), Teutë Rrusta, ka thënë se Ekipi Menaxhues nuk është shkarkuar pasi, sipas saj, atij i ka përfunduar mandati. Ajo ka thënë se përfaqësuesit e pushtetit janë duke manipuluar me terme. “Ekipi Menaxhues nuk është shkarkuar siç po trumbetohet nga deputetë të pushtetit. Atij i ka përfunduar mandati. Mos manipuloni me terma. Punë e madhe do të ishte shkarkimi para takimit të 2 majit. Ç'na duhej puna e propozimi i tij? Ai grup dihet çfarë pikëpamje ka për shtetin e Kosovës”, ka shkruar Rrusta në “Facebook”.

# Haradinaj: ShBA -ja dhe BE-ja kanë një draft-statut për Asociacionin në përputhje me Kushtetutën

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka quajtur të papranueshëm draft-statutin e Asociacionit të propozuar të martën në Bruksel nga Ekipi Menaxhues, i cili tashmë është shkarkuar nga Qeveria e Kosovës. Sipas tij, Asociacioni është një e keqe e trashëguar, por i njëjti duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Andaj Haradinaj beson se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë një draft-statut për Asociacionin, i cili është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. “Kosova e ka të pamundshme të pranojë një draft-statut që bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, edhe po të ishte vullnet i kujtdo qoftë. Është ditur herët se si do të jetë rezultati i këtij komisioni, sepse është ditur çfarë do të propozojë. Në fakt, shkarkimi nuk është i vlefshëm pasi ata e kanë dhënë produktin. Ky, në fakt, nuk është shkarkim, pasi ata e kanë kryer pjesën e vet të punës. Dalja për këtë është prapë te ndërmjetësit, meqenëse amerikanët dhe BE-ja janë në dijeni se statuti i Asociacionit nuk mund të jetë jokushtetues dhe joligjor. Pra do të ishte e mirë ndërhyrja e tyre në këtë kohë dhe jo lufta mes palëve”, ka thënë Haradinaj.

Në një prononcim para gazetarëve në Kuvend, Haradinaj është shprehur se zgjidhja se si të vazhdohet tutje për themelimin e Asociacionit u takon ndërmjetësuesve të dialogut. “Besoj shumë se zgjidhja tani është tek amerikanët dhe BE-ja, që ata vetë ta marrin ndërmjetësimin dhe të propozojnë një draft-statut që është në përputhje me Kushtetutën”, ka thënë ai.

Në anën tjetër, ish-ambasadori Avni Arifi ka thënë se Ekipi Menaxhues është krijuar mbi vlera antievropiane. “Ekipi Menaxhues është një trup bastard i krijuar me rrethana dhe vlera tërësisht antievropiane dhe tërësisht e pashpjegueshme se me çfarë logjike është propozuar krijimi i tij, edhe më absurd si është pranuar krijimi i tij. Athua çfarë u ka shkuar në mendje atyre që e pranuan këtë organ dhe formën e organizimit të tij?! Mbase një ditë do të dinë ta sqarojnë ata që e pranuan. Pavarësisht prej rrethanave dhe mënyrës së krijimit të tij, askund nuk shkruan që Ekipi Menaxhues ka të drejtë të japë propozime që janë pastër në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Aq më parë kur ky propozim konsiderohet si ‘propozim nga pala kosovare’. Asnjë propozim që nuk ka bazë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk është dhe nuk mund të jetë propozim i Kosovës”, ka shkruar Arifi në “Facebook”.

Ai ka thënë se do të ishte gabim fatal për Kosovën nëse draft-statuti i Asociacionit do të merret si bazë për të vazhduar tutje. “Nëse propozimi i sotshëm është në kundërshtim të Kushtetutës (siç po spekulohet), gabimi i Qeverisë së Kosovës nuk do të ishte vetëm kushtimisht pranimi i një statuti të tillë. Gabim edhe më i madh e, mbase, historik, do të jetë nëse ky dokument shërben si bazë për negociata të mëtutjeshme. Kjo do të ishte katastrofale dhe ky gabim nuk do të duhej t'i falej askujt”, ka shkruar ai.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për formimin e Asociacionit në vitin 2013, ndërsa për parimet e tij janë pajtuar në vitin 2015. Në vitin 2016 Ministria e atëhershme e Administrimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë ka emëruar Ekipin Menaxhues për hartimin e draft-statutit.

Por, marrëveshja për Asociacion nuk është zbatuar kurrë për shkak të këmbënguljes së Beogradit që ai të ketë kompetenca të gjera. Prishtina i ka refuzuar ato, me arsyetimin se mund ta kërcënojnë funksionalitetin e shtetit. Kosova është nën trysninë e ndërkombëtarëve për ta formuar Asociacionin. Ndonëse nuk përmendet në mënyrë specifike, ky mekanizëm përfshihet edhe në një marrëveshje të re që kanë arritur Kosova dhe Serbia me qëllim normalizimin e marrëdhënieve në fund të shkurtit.

# Konjufca: Vendimi për lirimin nga detyra e Ekipit Menaxhues, i drejtë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka komentuar takimin e Brukselit në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Konjufca ka thënë se zhvillimet në atë takim kanë qenë të pritshme për Kosovën. Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Konjufca ka thënë se qëndrimi i ekipit menaxhues në takimin e Brukselit ka qenë tronditës për Kosovën. “Sa iu përket diskutimeve në Bruksel, gjithçka ishte e pritshme lidhur me atë që ndodhi. Pra, ekipi menaxhues, i cili ishte vendosur prej qeverive të mëparshme të Kosovës, pati një qëndrim vërtet tronditës për ne. Meqenëse atje i prezantoi interesat e Republikës së Serbisë, jo interesat e Republikës së Kosovës”, ka thënë Konjufca.

Për emërimin e këtij ekipi ai i ka fajësuar qeveritë e kaluara. “Po e shini edhe vetë se çfarë ekipe menaxhuese dhe çfarë institucione kanë vendosur qeveritë e mëparshme. Kanë vendosur zyrtarë të cilët absolutisht nuk kanë lidhje me interesat e Kosovës, bile-bile njëra prej tyre, sa dëgjova, ishte pas bërë deputete në Parlament të Serbisë dhe ishte deputete e partisë së Aleksandër Vuçiqit”, është shprehur Konjufca. Sipas tij, veprimi i qeverisë për t'i liruar nga detyra anëtarët e atij ekipi ka qenë i drejtë. “Kështu që nuk patëm ne çka të presim tjetër prej këtij Ekipi Menaxhues. Ky Ekip Menaxhues e prezantoi një draft-statut i cili është një Republikë Serbe brenda Kosovës. Kjo natyrisht që është e papranueshme për qeverinë tonë, për institucionet tona, gjithçka do të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, çdo zgjidhje që u jepet përtej kornizave të Kushtetutës është e pavlefshme dhe mua më pëlqeu shumë dhe jam para këtij akti të qeverisë për ta shkarkuar Ekipin Menaxhues, sepse ishte grup i cili përfaqësonte interesat e Aleksandër Vuçiqit e jo interesat e popullit tonë. Nuk ka çka të kërkojë në pozicione zyrtare dhe nuk ka se si ta përfaqësojë popullin dhe qytetarët e Kosovës. Ata e përfaqësuan Serbinë ditën e djeshme. Unë para një jave kam pas bërë thirrje që ky ekip të shkarkohet”, ka deklaruar Konjufca.



## Projekti kapital i zhvillimit të Prishtinës së Re po vazhdon

**Prishtinë, 3 maj** - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se projekti kapital i zhvillimit të Prishtinës së Re po vazhdon me ritëm të lartë. "Rruga 'Jim Xhema' (Rruga 'A') është e rëndësisë së veçantë, ngaqë i lidhë vendbanimet, lagjet, autoudhët, rrugët nacionale dhe regjionale, unazën e brendshme të qytetit ndërmjet vete. Punët janë në progres, duke i dhënë fund kutërbimeve nga kanalizimi i hapur dhe rrezikshmërisë për fëmijët", ka njoftuar komuna e Prishtinës.



# Promovohet libri "Kujtesa e Trepçës - 100 rrëfime të punëtorëve të Trepçës"

**Mitrovicë, 3 maj** - Në hapësirat e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nën organizimin e organizatës "7 Arte", të mërkurën është bërë përurimi i librit "Kujtesa e Trepçës - 100 rrëfime të punëtorëve të Trepçës". Të pranishëm në këtë promovim libri ishin nënkryetari i komunës Arian Tahiri, drejtoresha e DKRS-së, Valdete Idrizi, rektori i Universitetit "Isa Boletini", Alush Musaj, ish-kryetari i komunës së Mitrovicës, Avni Kastrati, ish-drejtori i kombinatit "Trepça", Burhan Kavaja, drejtori i OJQ-së "7 Arte", Lulzim Hoti, hulumtuesit shkencorë që kontribuuan në mbledhjen e rrëfimeve, protagonistët e rrëfimeve, historianë, artistë, profesorë, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera.

Në fjalën e tij, nënkryetari Tahiri ka theksuar se është nder dhe kënaqësi që ndodhet në mesin e shumë intelektualëve dhe minatorëve të cilët janë pjesë e historisë së qytetit dhe vendit tonë. Libri dokumenton historinë dhe jetën sociale e kulturore të përjetuar nga ish-punëtorët e Trepçës, e shpalosur përmes rrëfimeve të tyre dhe do t'i shërbejë qytetit të Mitrovicës dhe vendit në përgjithësi.




# Asgjësohen mbi 1 000 produkte ushqimore dhe shqiptohen gjoba për bizneset në Skenderaj





**Skenderaj, 3 maj** - Drejtoria e Inspeksionit e komunës së Skenderajt ka konfiskuar mbi 1 373 produkte ushqimore jo të sigurta për konsum (të dëmtuara, pa deklaracion dhe me afat të skaduar). Sipas njoftimit të komunës, ky aktivitet inspektues u bë me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve nga ushqimet jo të sigurta për konsum.

Ndaj operatorëve ekonomikë, konform ligjit, thuhet se janë marrë masa ndëshkimore, duke shqiptuar tetë gjoba. "Të gjitha produktet e lartcekura, në prani të inspektorëve komunalë, janë asgjësuar nga ndërmarrja publike 'Uniteti'. Drejtoria e Inspeksionit apelon të gjithë qytetarët, që për çdo parregullsi që hasin gjatë marrjes së shërbimeve dhe për çdo lloj ankese, t'i drejtohen kësaj drejtorie", thuhet në njoftimin për medie të komunës së Skenderajt.

Komuna ka deklaruar se të gjitha rastet, ankesat apo kërkesat e qytetarëve do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe, konform gjetjeve, do të merren masa ligjore ndaj të gjithë shkelësve të ligjit.

# Komuniteteve pakicë u bëhet thirrje të aplikojnë në konkursin e Policisë së Kosovës



**Shtërpcë, 3 maj** - Drejtori rajonal i Policisë, nënkoloneli Basri Shabani, me stafin e tij të lartë, ka mbajtur një takim informues me përfaqësuesit e komunitetit në komunën e Shtërpcës. Qëllimi i këtij takimi ishte t'u bëhet thirrje dhe të njoftohen të rinjtë e komuniteteve pakicë për të aplikuar në konkursin e shpallur nga Policia e Kosovës.

Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj do t'i vazhdojë takimet me komunitetin joshumicë edhe në ditët në vijim në rajonin e Ferizajt me qëllim të inkurajimit të të rinjve për të aplikuar në Policinë e Kosovës. "Policia e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga komuniteti pakicë sipas kritereve të përcaktuara për aplikim", theksohet në njoftimin për medie të Policisë së Kosovës.

## Komuna e Prizrenit vazhdon t'i përkrahë fermerët

**Prizren, 3 maj** - Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në komunën e Prizrenit ka vazhduar përkrahjen për fermerët. Pas shpërndarjes së motokultivatorëve dhe mjeteve të tjera për punimin e tokës, fermerët e komunës së Prizrenit janë përkrahur edhe me ngritjen e 40 serave (10 sera nga 5 ari, 20 të tjera nga 2.40 ari dhe 10 sera me nga 1.40 ari). "Ky investim është mbështetje dhe nxitje për fermerët që të përkushtohen në bujqësi, gjë që është traditë në komunën tonë, e cila ka tokë të përshtatshme për kultivimin e kulturave të shumta bujqësore. Natyrisht, mbetemi të përkushtuar që ky trend të vazhdojë në të ardhmen", ka njoftuar komuna e Prizrenit.



# AGK-ja, thirrje prokurorëve dhe gjyqtarëve t'i trajtojnë me prioritet rastet e dhunës ndaj gazetarëve

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Bordi i Asociacionit i Gazetarëve të Kosovës të mërkurën, për nder të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, ka mbajtur një deklaratë për medie përballë Pallatit të Drejtësisë, me të cilën u ka bërë thirrje prokurorëve dhe gjyqtarëve t'i trajtojnë me prioritet rastet e dhunës ndaj gazetarëve. "Përmes kësaj shkrese na lejoni t'i shprehim shqetësimet tona në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës kundër gazetarëve duke kërkuar nga ana juaj, si pjesa kryesore e sistemit të drejtësisë, ta trajtoni me seriozitet më të madh mbrojtjen e gazetarëve nga dhuna e cila vjen si rezultat i ushtrimit të aktivitetit të tyre si raportues të çështjeve të cilat përbëjnë interes publik. Në pesë vjetët e fundit AGK-ja ka regjistruar 120 raste kërcënimesh ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medieve. Gjithsej 17 raste janë regjistruar në vitin 2018, 21 raste në vitin 2019, 24 raste në vitin 2020, 29 raste në vitin 2021 dhe 33 raste gjatë vitit 2022. Vetëm këtë vit deri në momentin që po flasim janë shënuar 11 raste sulmesh, me më të rëndin atë fizik kundër gazetarit Valon Syla. Kështu, numri i rasteve të kërcënimeve, sulmeve dhe ngacmimeve ndaj gazetarëve, është rritur vit pas viti", thuhet në këtë deklaratë të lexuar nga kryetari i Bordit të AGK-së, Xhemajl Rexha.

Në këtë deklaratë thuhet se sulmet ndaj gazetarëve, pos që paraqesin vepra penale kundër jetës dhe trupit, ato cenojnë edhe një prej lirive bazë në një shoqëri demokratike, që është liria e shprehjes. "Duke mos minimizuar rrezikun e asnjë vepre penale, rastet e sulmeve ndaj gazetarëve kanë një rrezikshmëri të veçantë që, përpos në palën e dëmtuar, e vënë në rrezik edhe lirinë e shprehjes së gazetarëve dhe lirinë e informimit të qytetarëve. Rritja e sulmeve ndaj gazetarëve kërkon reagim urgjent dhe adekuat nga ana e sistemit të drejtësisë", thuhet në deklaratë.

AGK-ja e vlerëson lart miratimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi me të cilin parashihet që rastet e gazetarëve të trajtohen brenda një afati të shkurtër kohor ashtu siç e vlerëson edhe caktimin e koordinatorëve për rastet e dhunës kundër gazetarëve nga ana e prokurorëve. "Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, shqetësimet tona kryesore mbesin kualifikimi i gabuar i veprave penale nga ana e prokurorëve ndaj sulmueseve të gazetarëve, kryesisht duke përzgjedhur vepra më të lehta penale dhe zvarritja e rasteve në gjykata dhe dënimet jashtëzakonisht të ulëta ndaj sulmuesve të gazetarëve të shqiptuara nga gjykatësit. Ne kërkojmë nga prokurorët që në rastet e sulmeve ndaj gazetarëve të ndërmarrin hetime profesionale dhe të pavarura dhe akuzat ndaj sulmuesve të gazetarëve t'i përpilojnë duke marrë parasysh jo vetëm rrethanat lehtësuese, por edhe ato rënduese me qëllim të dekurajimit të sulmeve ndaj gazetarëve. Nga gjyqtarët kërkojmë që rastet e sulmeve ndaj gazetarëve të trajtohen me prioritet të lartë dhe sulmuesit të marrin dënime që reflektojnë rrezikshmërinë që iu kanoset gazetarëve e jo të shqiptohen dënime të lehta", është theksuar në deklaratën e AGK-së.

Duke pasur për bazë misionin e AGK-së në mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e gazetarëve, promovimin, inkurajimin dhe përmirësimin e gazetarisë cilësore dhe të hapur në Kosovë, si dhe pozitën e gazetarëve në Kosovë, është shprehur gatishmëri e plotë e AGK-së, për çfarëdo forme të bashkëpunimit, e cila ka për qëllim sigurinë e gazetarëve dhe krijimin e një mjedisi të lirë medial.



# RSF, Kosova shënon përparim për pesë vende, por gazetarët sulmohen nga politika

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Reporterët Pa Kufij ka publikuar të mërkurën Indeksin e Lirisë së Shtypit Botëror dhe e ka renditur Kosovën në vendin e 56, pesë vende më mirë se vitin e kaluar, ku ishte renditur në pozitën e 61-të. Raporti konsideron skenën mediale të Kosovës si diverse, por që gazetarët vazhdojnë të mbeten cak i sulmeve nga politikanët. Teksa përmend edhe Komisionin e Pavarur të Medieve, që është përfshirë në një rast korrupsioni si dhe kritikon përzgjedhjen e drejtorit të transmetuesit publik. "Rregullatori i medieve, KPM, ka qenë joefektiv dhe së fundmi është përfshirë në një rast korrupsioni. Pavarësia e transmetuesit publik, RTK, është vënë në pikëpyetje për shkak të zgjedhjes si drejtor një aleat i partisë në pushtet. Mediet në gjuhën serbe janë ankuar për diskriminim në qasjen në informacione publike, veçanërisht në gjuhën e pakicës kushtetuese".

Raporti, gjithashtu, përmend edhe ekspozimin e gazetarëve ndaj sulmeve fizike nga grupe të caktuara të interesit, si dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe ekipeve televizive në fund të vitit në veri të Kosovës. "Vrasjet dhe zhdukjet që kanë ndodhur para dhe gjatë luftës në Kosovë (1998-2005) kanë mbetur të pandëshkuara. Gazetarët që hetojnë trafikimin e drogës ose ndotjen e mjedisit janë ekspozuar ndaj sulmeve fizike dhe raportimi i tyre është tentuar të pengohet nga grupet kriminale. Edhe pse sulmet hetohen nga policia dhe zyra e prokurorit, ato rrallëherë çojnë në procedime ligjore. Sulmet kundër gazetarëve në veri të Kosovës u shtuan gjatë një periudhe tensioni politik në mes të Prishtinës dhe Beogradit në fund të vitit 2021". Një pjesë e raportit u referohet vështirësive financiare të medieve, me theks atyre të komuniteteve pakicë.



| POS. | COUNTRIES | GLOBAL SCORE | SCORE POL. | SCORE ECO. | SCORE LEGIS. | SCORE SOC. | SCORE SECU. | DIF. POSITION 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 49 | Armenia | 70.61 | 63.75 | 48.53 | 73.82 | 82.95 | 83.98 | ▲ 2 |
| 50 | Slovenia | 70.59 | 66.25 | 46.41 | 79.64 | 75.95 | 84.72 | ▲ 4 |
| 51 | Belize | 70.49 | 61.98 | 53.92 | 68.11 | 79.55 | 88.89 | ▼ -4 |
| 52 | Uruguay | 70.33 | 62.73 | 55.08 | 78.73 | 74.9 | 80.2 | ▼ -8 |
| 53 | Romania | 69.04 | 59.65 | 49.24 | 71.86 | 81.44 | 83.03 | ▲ 3 |
| 54 | Ivory Coast | 68.83 | 66.98 | 58.01 | 71.07 | 76.33 | 71.79 | ▼ -17 |
| 55 | Cyprus | 68.62 | 64.66 | 53.12 | 71.89 | 64.98 | 88.44 | ▲ 10 |
| 56 | Kosovo | 68.38 | 62.95 | 50.28 | 80.26 | 75.49 | 72.95 | ▲ 5 |
| 57 | Poland | 67.66 | 50.15 | 55.02 | 69.03 | 78.28 | 85.82 | ▲ 9 |
| 58 | Burkina Faso | 67.64 | 62.81 | 58.33 | 67.45 | 81.25 | 75.55 | ▼ -17 |
| 59 | Papua New Guinea | 67.62 | 59.58 | 51.31 | 66.35 | 71.97 | 88.89 | ▲ 3 |
| 60 | Guyana | 67.5 | 54.69 | 58.82 | 59.43 | 79.83 | 84.72 | ▼ -26 |

# KDI-ja: Ku janë inspektorët e ‘premtuar’ të punës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU




PRISHTINË, 3 MAJ - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar të mërkurën një tryezë të diskutimit me kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi, drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Bislim Bislimi, si dhe kryetarin e Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi. Kjo tryezë është organizuar në vazhdën e zhvillimeve të fundit lidhur me rritjen e numrit të inspektorëve të punës si dhe nevojës imediate për monitorimin e zbatimit të ligjit të punës.

Në këtë tryezë u publikua punimi diskutues “Ku janë inspektorët e ‘premtuar’ të punës?”. Albesa Humolli nga KDI-ja shpalosi gjetjet kryesore të këtij hulumtimi, ndër të cilat u theksua se, pavarësisht prej lëvizjeve pozitive në drejtim të përmbushjes së premtimit për rritjen e numrit të inspektorëve, procesi i rekrutimit të inspektorëve të rinj të punës është ende në hapat e parë.

Punimi trajton sfidat me të cilat po përballen institucionet e përfshira në procesin e rekrutimit të inspektorëve të punës, duke përfshirë dështimin e konkurseve të brendshme për inspektorë të punës për shkak të mosinteresimit të shërbyesve civilë, mungesën e kategorizimit si grup pune të pozitës “inspektor i punës”, mungesën e kapaciteteve të DMZP-së, mosfunksionalizimin e Komisionit Kombëtar të Klasifikimit si dhe mungesën e Komisionit Shtetëror të Pranimit. Humolli ka theksuar se rritja e numrit të inspektorëve dhe kapaciteteve të Inspektoratit të Punës janë mënyra më e mirë për të siguruar respektim të të drejtave të punës.

Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi, nënvizoi nevojën urgjente për rritjen e numrit të inspektorëve dhe përmendi sfidat e Inspektoratit në rekrutimin e 100 inspektorëve të rinj të punës. Nikçi shprehu optimizëm se për konkurset e shpallura nga inspektorati do të ketë më shumë interesim për shkak se me Ligjin e ri për Paga do të ketë pagë më të dinjitetshme për inspektorët e punës për shkak të rangimit më të mirë të pozitës dhe shtesave të rrezikshmërisë në punë.

Ndërsa drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Bislim Bislimi, potencoi se me reformimin e administratës publike, e gjithë barra e rekrutimit të jashtëm për nevojat e administratës publike ka kaluar në këtë departament. Megjithatë, duke qenë se kjo reformë është zbatuar pa përgatitje, udhëzime apo trajnime paraprake, departamenti nuk ka arritur të zhvillojë asnjë procedurë të rekrutimit të jashtëm për më tepër se tre vjet.

Bislimi përmendi sfidat ligjore e procedurale me të cilat është përcjell rekrutimi i inspektorëve të punës, por shtoi se është adresuar çështja e formimit të grupit të punës ‘inspektor’, është funksionalizuar Komisioni Kombëtar i Klasifikimit, ndërsa shumë shpejt pritet të formohen edhe Komisionet Shtetërore të Pranimit. Sipas Bislimit, këto zgjidhje kanë trasuar rrugën për rekrutimin e inspektorëve të punës, me ç’rast javën e kaluar është shpallur konkursi për 19 inspektorë të rinj të punës.

Në anën tjetër, kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, vlerëson se shkeljet nga marrëdhënia e punës janë alarmante dhe rritja e numrit të inspektorëve është më se e nevojshme. Sipas Azemit, mungon vullneti institucional për t’i tejkaluar problemet ligjore në lidhje me rekrutimin e inspektorëve të punës dhe se inspektorët tashmë do të duhet të ishin rekrutuar, duke qenë se buxheti veçse i është alokuar Inspektoratit në fillim të vitit 2023.

Të pranishmit ngritën për diskutim çështjen e digjitalizimit të punës së Inspektoratit, trajnimeve për inspektorët e rinj të punës, si dhe bashkëpunimin me inspektoratet e tjera, në veçanti Inspektorin e Përgjithshëm.

# Nënshkruhen dy marrëveshje për subvencionimin e Trepçës me 1.87 milion euro



PRISHTINË, 3 MAJ - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku dhe ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv të Trepçës, Enis Abdurrahmani, kanë nënshkruar dy marrëveshje për subvencionimin e ndërmarrjes me 1.87 milion euro. Me këto mjete “Trepça Sh. A” do të kryejë investime kapitale prej 970 mijë eurosh në tri njësitë biznesore në mbarë republikën, minierat me flotacion në Stantërg, Kishnicë-Artanë dhe Kopaonik-Leposaviq dhe do të mbulojë shpenzime operative në vlerë 900 mijë euro. Deri në fund të vitit ndërmarrja do të përfitojë 3 milionë euro subvencione nga Ministria e Ekonomisë si dhe kredi 20 milionë euro nga Qeveria e Republikës për investime kapitale në makineri minerare dhe flotacion të ri.

Marrëveshjet u nënshkruan në mjediset e njësisë biznesore Kishnicë-Artanë, ku i pranishëm ishte edhe nënkryetari i komunës së Graçanicës, Leutrim Ajeti.

“Trepça “Sh. A.” ka mbyllur vitin 2022 me bilanc pozitiv për herë të parë që nga përfundimi i luftës.

## Rritet në 7 për qind inflacioni në Eurozonë



PRISHTINË, 3 MAJ - Norma vjetore e inflacionit të konsumatorit në Eurozonë u rrit në 7 për qind në muajin prill për shkak të rritjes së kostove të energjisë, duke përmbushur parashikimet e tregut. Sipas vlerësimeve të Zyrës Evropiane të Statistikave, inflacioni shënoi rritje nga niveli më i ulët 13-mujor prej 6.9-përqindësh në muajin mars, pra pas katër muajve rënie. Çmimi i energjisë në bazë vjetore u rrit 2.5 për qind, pasi ra 0.9 për qind në muajin mars. Ndërsa kostot e ushqimeve, alkoolit dhe duhanit pritet ta kenë normën më të lartë vjetore në muajin prill me 13.6 për qind, duke zbritur nga 15.5 për qind në muajin mars. Në bazë mujore, indeksi i konsumit në Eurozonë u rrit 0.7 për qind në muajin prill. Kostoja e energjisë në zonën e monedhës së vetme vlerësohet të ketë rënë me 0.8 për qind në bazë mujore.

# Si shmanget lufta e SHBA-së me Kinën




Nga Nicholas **KRISTOF**
*"New York Times"*

Në verën e vitit 1914, pakkush e dëshironte luftën ose mendonte se një luftë e madhe ishte e mundur. Gjyshërit e mi u martuan atë pranverë në Lviv, në atë kohë pjesë e perandorisë Austro-Hungareze.

Unë shoh sot fotot e tyre të dasmës dhe kuptoj se ata nuk e kishin idenë se një kataklizëm do të zhdukte së shpejti vendin e tyre, do të shkatërronte jetët e tyre dhe në fund do të detyronte emigrimin e një pjese të familjes në Botën e re (SHBA). Këtë vit herë pas here shqetësohem se nuk po i marrim seriozisht në konsideratë rreziqet e konfliktit që kemi përpara.

Dhe ndoshta rreziku më i keq gjeopolitik gjatë një ose dy dekadave të ardhshme është një luftë me Kinën. Ndërsa asnjëra palë nuk dëshiron luftë, secila tashmë pranon se konflikti mund të jetë i afërt dhe po përgatitet në përputhje me rrethanat – duke ngritur dyshime në anën tjetër dhe duke nxitur një garë armësh.

Është koha që të dyja palët të marrin frymë thellë dhe të tërhiqen nga retorika dhe goditjet simbolike që mbledhin nacionalistët në shtëpi, por që rrisin gjithashtu rreziqet e një katastrofe globale. Rreziqet na erdhën në kujtesë të hënën, kur Kina dërgoi një numër rekord avionësh ushtarakë pranë Tajvanit, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë pritjes së ngrohtë që Shtetet e Bashkuara i bënë presidentit të Tajvanit.

"Gjërat e bëra publikisht, në mënyrë simbolike, për t'i bërë ballë Pekinit nuk e bëjnë domosdoshmërisht Tajvanin të jetë më i sigurt," vuri në dukje Jessica Chen Weiss nga Universiteti Cornell. Për shembull, ish-kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosibëri një udhëtim në Tajvan vitin e kaluar në atë që duhej të ishte një shfaqje simbolike e mbështetjes ndaj këtij vendi. Sipas asaj që zbuluan sondazhet pjesa më e madhe e banorëve të Tajvanit arritën në përfundimin se vizita e Pelosit i bëri ata të ndjehen më pak të sigurt.

Nëse duam ta ndihmojmë Tajvanin, tha Weiss, kemi nevojë për më shumë parandalim dhe më pak provokim.

Sipas mendimit tim, rreziqet e konfliktit nxiten kryesisht nga Xi Jinping, nga represioni i tij brutal në Xinjiang tek zgjerimi i madh i arsenalit të tij bërthamor që po zhvillohet tani, dhe tensionet do të përkeqësohen shumë nëse ai furnizon Rusinë me predha artilerie.

Por politika e brendshme amerikane po drejton gjithashtu një kurs përplasjeje, dhe kjo mund të përkeqësohet ndërsa demokratët dhe republikanët konkurrojnë për të denoncuar Kinën.

Nga pikëpamja amerikane, një tjetër luftë e ftohtë mund të mos duket aq e tmerrshme, pasi ne dhe rusët arritëm të shmangnim djegien e njëri-tjetrit në atë të fundit.

Por miliona njerëz vdiqën në luftën e fundit të ftohtë në zonat ndërmjetëse të luftës nga Vietnami në Angola. Rusia dhe Shtetet e Bashkuara e shmangën luftën bërthamore pjesërisht sepse liderët nga secila palë kishin kujtime të Luftës së Dytë Botërore.

Kjo bëri që ata të ishin më të kujdesshëm; Kam frikë se sot, ashtu si në vitin 1914, besimi i tepërt dhe presionet politike miopike nga secila palë mund të nxisin përshkallëzimin e vazhdueshëm. Nuk kam nevojë të kujtoj se sa shtypëse mund të jetë Kina: isha në sheshin Tiananmen në qershor të vitit 1989 dhe isha dëshmitarë kur Ushtria Çlirimtare Popullore qëlloi mbi turmën ku bëja pjesë.

Por pashë gjithashtu Kinën duke nxjerrë nga varfëria më shumë njerëz se çdo vend tjetër në histori, dhe duke përmirësuar ndjeshëm rezultatet e arsimit dhe shëndetësisë. Ne në Shtetet e Bashkuara duhet të përballemi me realitetin e pakëndshëm që një i porsalindur në Pekin mund të mos jetë në gjendje të presë me padurim një votë kuptimplotë apo fjalën e lirë, por ka një perspektivë për të jetuar shtatë vjet më të shumë se një i porsalinduri në Uashington, DC.

Kur them se duhet të flasim me njëri-tjetrin, nuk po i minimizoj shqetësimet amerikane. Unë jam ndër ata që janë të kujdesshëm ndaj TikTok për shkak të rrezikut që mund të përdoret për spiunim. Por unë gjithashtu e di se Shtetet e Bashkuara kanë përdorur në mënyrë të ngjashme bizneset private për të spiunuar Kinën. Kur Kina bleu një Boeing 767 të ri në vitin 2000 për të qenë ekuivalenti kinez i Air Force One, zyrtarët amerikanë vendosën të paktën 27 përgjues në të.

Mendoj se Shtetet e Bashkuara duhet të ushtrojnë presion ndaj Kinës për disa çështje, siç është mënyra e pamatur që kompanitë kineze eksportojnë kimikate në Meksikë që kthehen në fentanil. Fentanili me origjinë kineze vret mijëra amerikanë çdo vit dhe është e vështirë të kuptosh pse vdekjet e kaq shumë njerëzve nuk përbëjnë rëndësi të veçantë në axhendëndypalëshe.

Por ne gjithashtu kemi nevojë për përulësi. Vetë politikanët amerikanë, kompanitë farmaceutike dhe rregullatorët e kanë goditur në mënyrë katastrofike krizën e opioideve. Pse duhet të presim që udhëheqësit kinezë të kujdesen më shumë për jetët e të rinjve amerikanë sesa vetë udhëheqësit tanë?

Shënjestrimi nuk është një politikë dhe ai i tjetërson qytetarët e zakonshëm kinezë, të cilët janë shpresa më e mirë e atij vendi pasi Xi të largohet nga skena. Kjo është një lojë e gjatë.

Retorika anti-kineze dhe shqetësimet mbi sigurinë e zmadhojnë racizmin ndaj amerikanëve aziatikë dhe i bëjnë kinezët të ndihen të padëshiruar në Amerikë – dhe kjo na lëndon të gjithëve.

Në vitin 2020, 17 për qind e diplomave të doktoraturës amerikane të dhëna në shkencë dhe inxhinieri shkuan për studentët kinezë, duke nënvizuar se SHBA ka përfituar së tepërmi nga ikja e trurit të Kinës. Por kjo situatë tani mund të ndryshojë: Një sondazh zbuloi shqetësim të thellë midis studiuesve kinezë në Amerikë, me 61 për qind prej tyre që thanë se kanë menduar të largohen.

Unë mbështes hapat e Presidentit Biden për të forcuar industrinë amerikane dhe përpjekjet e tij të jashtëzakonshme për të rritur gatishmërinë ushtarake në Paqësorin Perëndimor. Por le ta pranojmë se hapi i vetëm më i rëndësishëm që mund të bëjmë për të forcuar Amerikën përballë Kinës nuk ka të bëjë fare me ushtrinë.

Do të ishte e thjeshtë të trajtonim ato që nuk funksionojnë në Amerikë – nga varësia te varfëria e fëmijëve dhe sistemi ynë i dështuar i kujdesit prindëror – dhe të investojmë në sistemin tonë arsimor në mënyrë që të prodhojmë qytetarë më të fortë dhe një komb më të fortë. Këto, dhe jo nacionalizmi problematik, është mësimi që duhet të marrim nga Kina – dhe kjo është mënyra më e mirë që ne të përballojmë sfidën e Kinës.





# Sport


Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Tri fitore nga skuadrat vendase

EPOKA E RE — Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 3 maj** - Në kuadër të javës së 32-të në Superligën e Kosovës në futboll, fitore kanë shënuar tri skuadrat vendase: Gjilani, Ferizaj dhe Malisheva ndaj Dukagjinit, Drenicës dhe Trepçës '89. Skuadra e Gjilanit ka realizuar fitore shumë të rëndësishme për pozitën e tretë ndaj Dukagjinit të Klinës me rezultat 2-0. Golin e parë në ndeshje e realizoi sulmuesi Mevlan Zeka në minutën e 28. Mysafirët u munduan të rikthehen në lojë por, pa sukses. Shtatë minuta pa përfunduar koha e rregullt e ndeshjes, Ardin Dallku i Dukagjinit u përjashtua me karton të kuq dhe i vështirësoi punët e mysafirëve për ta gjetur golin e barazimit. Në anën tjetër, në minutat shtesë, Zeka realizoi edhe golin e dytë për vendasit për rezultatin final 2-0. Pas kësaj ndeshjeje, Gjilani përforcohet në pozitën e tretë me 50 pikë, derisa skuadra nga Klina është e pesta me 41 pikë.

Trajneri i Gjilanit, Zekirija Ramadani, ka thënë se skuadra e tij fitoi me meritë ndaj Dukagjinit. "Mendoj se me plot meritë arritëm te ky trepikësh. I uroj futbollistët për fitoren. Falënderoj edhe tifozët që na mbështetën dhe shpresoj që deri në fund të na rrinë afër. Jemi afër Evropës, por duhet të jemi të kujdesshëm", ka thënë Ramadani.

Në ndeshjen tjetër Ferizaj ka rrëmbyer tri pikë të plota në ndeshjen ndaj Drenicës në Skenderajt, pasi e ka mposhtur me rezultatin 2-0. Pjesa e parë përfundoi pa gola të shënuara, derisa vendasit në fillim të pjesës së dytë kaluan në epërsi me golin e Krasniqit. Hussein i Drenicës u përjashtua me pas



me karton të kuq, sikurse edhe Cakolli i Ferizajt. Ndërsa në minutën e 73-të Betim Haxhimusa realizoi golin e dytë për rezultatin final 2-0. Ferizaj tash ka grumbulluar 34 pikë, aq sa ka edhe Trepça '89. Ndërsa Drenica vazhdon të jetë në fund të renditjes tabelore me 23 pikë.

Fitore si vendase dhe tepër të vështirë ka shënuar edhe skuadra e Malishevës, e cila e ka

**SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Gjilani - Dukagjini | 2-0 |
| Ferizaj - Drenica | 2-0 |
| Malisheva - Trepça '89 | 1-0 |

Të enjten takohen:
15:00 Ballkani - Prishtina
15:00 Llapi - Drita

mposhtur Trepçën '89 me rezultat minimal 1-0. Golin për tri pikët e malishevasve e shënoi Tolaj në minutën e 32-të. Pas kësaj ndeshjeje skuadra e Bylbyl Sokolit ka 39 pikë dhe është në rrugë të mirë për të mbetur edhe një edicion në elitën e futbollit të Kosovës, derisa 89-shi zë pozitën e nëntë me 34 pikë.

Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshje shumë interesante në kuadër të javës së 32-të. Përballen Ballkani - Prishtina dhe Llapi - Drita.

# Shtatë vjet nga anëtarësimi i Kosovës në UEFA




**Prishtinë, 3 maj** - Më 3 maj të vitit 2016, me 28 vota për, 24 kundër dhe dy abstenime, në kongresin e UEFA-s Kosova u pranua anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë evropiane të futbollit. Me anëtarësimin e saj në UEFA, Kosova u bë anëtarja e 55-të asokohe e qeverisë evropiane të futbollit. Asokohe presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, legjenda e futbollit tonë, Fadil Vokrri, e cilësoi këtë anëtarësim historik dhe drejtësi e vonuar. "Një drejtësi e vonuar por, duke marrë parasysh bllokadat ligjore që i janë paraqitur Kosovës, ne arritëm të pranohemi. Kjo është një arritur e jashtëzakonshme. Momentet brenda kuvendit të UEFA-as ishin të vështira për shkak të kahes që i dhanë kuvendit disa shtete", kishte deklaruar Vokrri.

Anëtarësimi i Kosovës në UEFA u mundësoi ekipeve të elitës së futbollit kosovar të jenë pjesëmarrëse në garat evropiane. Po ashtu, kjo gjë i hapi rrugën Kosovës të anëtarësohet edhe në Federatën Botërore të Futbollit – FIFA, në kongresin e mbajtur më 12 dhe 13 maj në Mexico City.

# Vavalis: Duhet të dominojmë ndaj Llapit sikurse ndaj Ferizajt

Gjilan, 3 maj - Trajneri i skuadrës së Dritës, Akis Vavalis, në konferencën për medie, në prag të ndeshjes kundër Llapit në kampionat, ka thënë se kundërshtarja e radhës është një skuadër e fortë. Trajneri grek ka thënë se i gjithë fokusi është në ndeshjen që zhvillohet sot (e enjte) në Podujevë dhe jo në atë ndaj Ballkanit. "Luajmë përballë një skuadre të fortë siç është Llapi. Do të jetë një ndeshje e vështirë. Unë jam shumë i lumtur për mënyrën se si futbollistët po stërviten. Së pari kam biseduar me futbollistët. Ata duhet të fokusohen te Llapi. Njerëzit mendojnë për Ballkanin, por ne jemi të fokusuar ndaj Llapit. Kemi stërvitur edhe në fushë me bari natyral që të përshtatemi edhe me fushën në Podujevë", ka thënë Vavalis. "Ditë pas ditësh djemtë po tregojnë një eufori, një forcë dhe po fillojnë ta implementojnë filozofinë time. Qëllimi im është që në ndeshjen e radhës të kemi një dominim sikurse ndaj Ferizajt. Gjithashtu, futbollistët pas çdo dite po më bëjnë më shumë optimist për ndeshjen e radhës", ka shtuar Vavalis.

Drita, pas 31 ndeshjeve, është lidere me 63 pikë, një më shumë se Ballkani.





## Xhaka: Besojmë ende në titull të kampionit

**Londër, 3 maj** - Derbi i Londrës përfundoi me fitoren bindëse të Arsenalit, ndërsa Chelsea nën drejtimin e Frank Lampardit tregoi edhe një herë "gropën e zezë" në të cilën janë futur. Ndeshja e luajtur në kuadër të javës së 34-t në Premierligë përfundoi me rezultatin 3-1, ndërsa një prej lojtarëve që shkëlqeu më së shumti ishte Granit Xhaka, i cili dha dy asistime. Xhaka foli pas ndeshjes në lidhje me titullin kampion, ku tha se, pavarësisht e City është më i avantazhuar, ata besojnë ende. "Mendoj se i merituam tre pikët. Unë mendoj se po. Ende besoj se është e mundur ta fitojmë titullin", ka thënë Xhaka për "Sky Sport".

## Atleti Izmir Smajlaj: I drejti nuk mposhtet kurrë

Tiranë, 3 maj - Për një periudhë të konsiderueshme kohore, atleti shqiptar, Izmir Smajlaj, ka qenë në një betejë ligjore dhe i pezulluar. Arsyeja ka qenë se Smajlaj akuzohej për mashtrim të një gare ku ai ishte pjesëmarrës. Megjithatë, atleti kampion ka reaguar me një postim në rrjetin social "Instagram", duke bërë me dije se tashmë është shpallur i pafajshëm dhe do të rikthehet në pistë. "I drejti nuk mposhtet kurrë! I pafajshëm! Falë një beteje të gjatë ligjore me AIU Sport Resolution, Gjykata Sportive Botërore, me seli në Londër, ka shpallur pafajësinë time kundrejt aludimeve për mashtrim ndaj një gare ku isha pjesëmarrës. Isha i bindur që gjyqtarët e huaj do ta vlerësonin të vërtetën dhe do ta kuptonin që çdo gjë që ishte hetuar ishte e gabuar dhe pa fakte ndaj meje, prandaj jam tejet i lumtur dhe me anë të këtij postimi ju komunikoj edhe rikthimin tim në pistë", është shprehur i lumtur Izmir Smajlaj.




# Dhjetë sportistët më të paguar në botë për vitin 2023

Jersey City, 3 maj - Revista e njohur "Forbes" ka publikuar listën me dhjetë sportistët më të paguar në botë në vitin 2023. Listës i prin Cristiano Ronaldo me 123 milionë euro, ndërsa pas tij vjen rivali i përhershëm, Lionel Messi, me 117 milionë euro. Sipas revistës "Forbes", kjo listë me 'top 10' sportistët më të paguar fitoi 1.1 miliard dollarë në 12 muajt e fundit. Këto fitime janë 12 për qind më shumë se 990 milionë dollarë vitin e kaluar dhe 5 për qind më shumë se rekordi prej 1.06 miliardë dollarësh i vendosur në vitin 2018. Cristiano Ronaldo është ai që fiton më shumë në mesin e 10 sportistëve më të paguar në botë 2023, ndërsa "Telegrafi" më poshtë ju sjell listën e plotë.




**LISTA E SPORTISTËVE**

| | |
|---|---|
| 1. Cristiano Ronaldo | (123 milionë euro) |
| 2. Lionel Messi | (117 milionë euro) |
| 3. Kylian Mbappe | (108.6 milionë euro) |
| 4. Lebron James | (108.2 milionë euro) |
| 5. Canelo Alvarez | (99.6 milionë euro) |
| 6. Dustin Johnson | (96.9 milionë euro) |
| 7. Phil Mickelson | (96 milionë euro) |
| 8. Stephen Curry | (90.9 milionë euro) |
| 9. Roger Federer | (86 milionë euro) |
| 10. Kevin Durant | (80.5 milionë euro) |

# Lakersat mposhtin kampionët në gjysmëfinalen e parë, barazim mes New Yorkit e Miamit

Nju-Jork, 3 maj - Lakersat fitojnë me rezultat 117-112 gjysmëfinalen e parë "play-off" ndaj Golden State, në fushën e këtij të fundit, duke udhëhequr 1-0 serinë e takimeve. Një ndeshje e ekuilibruar dhe e hapur deri në fund, ku për miqtë 5 lojtarë realizuan mbi 19 pikë. Diferencën e bëri Anthony Davis, autor i 30 pikëve e 23 reboundeve, ndërsa LeBron Jamesi e mbylli me 22 pikë e 11 rebounde. Në kahun tjetër, Curry realizoi 27 pikë, Thompsoni 25 e Poole 21 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen e kampionëve në fuqi të NBA-së. Në Konferencën e Lindjes, ekuilibër pas dy ndeshjeve të para mes New Yorkut e Miamit. Njujorkezët fituan me rezultat 111-105 ndaj rivalëve nga Florida në shtëpinë e tyre, duke barazuar 1-1 serinë. Brunsoni me 30 pikë ishte më i miri në fushë për New Yorkun, mbështetur edhe nga Randle me 25 pikë e Barretti me 24 pikë. Te Miami u ndje mungesa e Butlerit (Martin 22 pikë).




**KONFERENCA E LINDJES, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE**

| | |
|---|---|
| Boston - Philadelphia | (0-1) |
| New York - Miami | 111-105 (1-1) |

**KONFERENCA E PERËNDIMIT, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE**

| | |
|---|---|
| Denver - Phoenix | (2-0) |

## SHKURT

### Guardiola: Askush nuk krahasohet me Messin

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, është pyetur edhe për krahasimin në mes të Haalandit dhe Messit. Strategu spanjoll ka deklaruar se askush nuk mund të krahasohet me yllin argjentinas. "Messi/Haaland? Nuk mund ta krahasosh asnjë lojtar me Messin. Leo është lojtari më i kompletuar që kam parë ndonjëherë. Vizioni, pasimet, duelet, shumë gjëra… shpresoj që Haaland t'i afrohet, do të ishte shumë mirë për ne", ka thënë Guardiola.

### Lampard: Ishim katastrofë, duhet të punojmë fort

Chelsea bëri edhe një tjetër ndeshje zhgënjyese në Premierligë, pasi humbi nga Arsenali në "Emirates" me rezultat 3-1. Aventura e dytë si trajner i Chelseas po shkon në mënyrën më të keqe të mundshme për Frank Lampardin, pasi në gjashtë ndeshje janë regjistruar gjashtë humbje. "Nuk ishim në lartësinë e duhur. Pjesa e parë ishte katastrofike për ne. Ishte shumë e thjeshtë të luaje ndaj nesh në 45 minutat e para. Në të dytën ishim më mirë. Luajtëm si skuadër dhe krijuam raste për gol. Do të punojmë fort që të ringrihemi", ka thënë Lampardi.

### Perezi paralajmëron Verstappenin: Do të veproj ashtu sikurse bëri Rosbergu me Hamiltonin

Fitorja e meksikanit Sergio Perez në garën e Bakus ka rritur shanset e tij për ta fituar titullin kampion në Formula 1 këtë sezon. Ai korri fitoren e dytë sezonale dhe është 6 pikë pas shokut të tij të skuadrës Max Verstappen. Të dy pilotët e Red Bullit kanë të njëjtën makinë, ndaj Perezi shpreson që këtë vit ta thyejë tabunë e të triumfojë në fund. Perezi shpreson të përsëritë atë që Nico Rosberg bëri me Lewis Hamiltonin në vitin 2016, kur gjermani u shpall kampion bote për pilotë në një duel të fortë brenda familjes. Marrëdhënia mes Perezit dhe Verstappenit nuk është shumë e mirë, sidomos pas fundit të sezonit të kaluar, kur holandezi nuk ndihmoi shokun e skuadrës të dilte i dyti në botëror. "Mes meje dhe Max ka shumë respekt. Këtë sezon po shtyjmë të dy në maksimum për të fituar e mundur njëri-tjetrin në pistë. Unë kam po aq dëshirë ta fitoj titullin sa edhe Max dhe do të vazhdojmë të duelojmë në pistë në çdo garë. Fitorja në Baku më motivon më shumë, pasi ka ende shumë gara përpara. Shpresoj të fitoj titullin ashtu sikurse bëri Rosbergu me Hamiltonin", u shpreh Perezi.

### Lajm i keq për Cityn, De Bruyne mungon ndaj Realit

Fati i keq ka goditur Manchester Cityn në pikën më të rëndësishme të sezonit, duke qenë se mesfushori Kevin De Bruyne është dëmtuar dhe rrezikon të mungojë për ndeshjet më të rëndësishme të sezonit në Ligën e Kampionëve ndaj Real Madridit. Trajneri Pep Guardiola ka konfirmuar mungesën e mesfushorit në dy ndeshjet kampionale, derisa për ndeshjen ndaj Realit ka thënë se do të vlerësohet situata gjatë ditëve në vazhdim.

## Leeds Unitedi shkarkon Javi Gracian, emëron Sam Allardyce

Javi Garcia është larguar nga pozita e trajnerit të skuadrës së Leeds Unitedit pas 12 ndeshjeve në krye të ekipit. Pozitën e kryetrajnerit te Leeds Unitedit e ka marrë menjëherë Sam Allardyce. Lajmin e ka bërë me dije klubi i Premierligës me anë të një komunikate të lëshuar në uebfaqen zyrtare. "Leeds Unitedi mund të konfirmojë se Javi Gracia do të largohet nga klubi pas 12 ndeshjeve në krye. Nga klubi do të largohen edhe Zigor Aranalde, Mikel Antia dhe Juan Solla, të cilët iu bashkuan Gracias", është thënë në komunikatën e klubit. Allardyce ka menaxhuar mbi 500 ndeshje në Premierligë në një karrierë menaxheriale që zgjat 29 vjet dhe ai ka përvojë në luftën për mbijetesë, pasi ka udhëhequr një numër të klubeve të tij të mëparshme që kanë synuar mbetjen në elitë. Ndeshja e tij e parë në krye të "Bardhezinjve" do të jetë udhëtimi i së shtunës në Premierligë kundër Manchester Cityt.

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalno Preduzeće za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" sh.a. d.d.
Nr.br. 1314 dt. 03-05-2023
Prishtinë - Pristina

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (nenit 21 parag.21), Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike (neni13), si dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi" SH.A, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2023 mori vendim që të rishpallë:

## KONKURS

**Pozita e punës: Sekretar /e - i/e Bordit të Drejtorëve /Këshilltar/e - i Përgjithëm**

**Kohëzgjatja e konktrates: 3 (tre) vite**

**Vendi : Prishtinë**

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- Mirëmbanë regjistrin e aksionarëve të Ndërmarrjes;
- Vepron si agjent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe /ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç kërkohet me ligj dhe aktet nënligjore;
- Kordinon me KE-në përgatitjen e shkresave (dokumenteve) për mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe shënon ato në librat e protokoleve;
- Pranon dhe distributon shkresat për Bordin e Drejtorëve;
- Ofron udhëzime juridike për Bordin e Drejtorëve;
- Kryen edhe punë tjera të kësaj fushe në bazë të kërkesës së Bordit të Drejtorve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndermarrjes;
- I raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes

**Përgatitja profesionale dhe Kualifikimi:**

- Të posedojë diplomë universitare në ligj dhe të plotësojë kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Njohuri të ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme;
- Shkathtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi dhe njoguri në programet operative Mikrosoft Ofice, (Word, Exel, Outlook, etj).

**Informata të përgjithshme:**

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 03.05.2023 deri me datë 18.05.2023 si datë e mbylljes së konkursit. Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A., Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Në rast nevoje për informacione shtesë mund të na kontaktoni në, tel: 038/603-191 prej orës 08:00 – 15:00.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentacioni i kërkuar:**

- CV (Biografinë);
- Deklarata nën betim (e cila do të merret në kopje fizike në ndërmarrje);
- Diplomen e fakultetit (kopje);
- Dëshmin mbi përvojen e punës apo trustin pensional;
- Kopjen e leternjoftimit (apo pasaportës);
- Certifikata mbi denimet penale (jo më e vjetër se 6 muaj).

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalno Preduzeće za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" sh.a. d.d.
Nr.br. 1314 dt. 03-05-2023
Prishtinë - Pristina

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima (član 21 stav 21.1), Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-87 o javnim preduzećima (član 13), Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, kao i odluka br. 612, od 24.02.2023, Upravni odbor KRM „Pastrimi" dd, Priština, na sastanku održanom datuma 28.04.2023. godine odlučio da ponovo objavi:

## KONKURS

**Radno mesto: Sekretar Upravnog odbora / Generalni savetnik**

**Trajanje ugovora: 3 (tri) godine**

**Mesto: Priština**

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Vodi registar akcionara Preduzeća;
- Deluje kao agent Preduzeća za prijem obaveštenja;
- Podnošenje svih podnesaka, publikacija i/ili obelodanjivanja relevantnim organima u skladu sa zakonom i podzakonskim aktima;
- Koordinira sa EK pripremu sažetaka i (dokumenata) Odbora direktora i Komisije za reviziju (osim ako njihov predsedavajući ne zahteva drugačije), i beleži ih u knjigama protokola;
- Prihvata i distribuira pisma Upravnom odboru;
- Pruža pravne smernice Upravnom odboru;
- obavlja i druge poslove u ovoj oblasti na osnovu zahteva Upravnog odbora i glavnog izvršnog direktora Preduzeća;
- Izveštaji Upravnom odboru i Glavnom izvršnom direktoru preduzeća

**Stručna priprema i kvalifikacija:**

- Poseduje fakultetsku diplomu pravnika i ispunjava uslove kvalifikacije i stručne podobnosti prema članu 17 Zakona o Javnim Preduzećima
- Poznavanje važećih zakona i podzakonskih akata;
- Veštine komunikacije, planiranja rada i vođenja tima;
- Veština i poznavanje operativnih programa Microsoft Office (Vord, Ekcel, Outlook, itd.).

**Opšte informacije:**

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 03.05.2023 do 18.05.2023 godine kao datuma zatvaranja konkursa. Obrazac prijave se prima i dostavlja u zatvorenoj koverti u arhivu KRM „Pastrimi" SH, ul. „Tahir Zajmi", br. 5, Priština.

Prijava putem pošte: Prijava sa dokumentima se može dostaviti i poštom na adresu: Ul. „Tahir Zajmi", br.5, Priština, 10000. Prijave poslate poštom moraju imati poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu. Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o dostavi izvršenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i smatraće se, ako stignu u roku od 3 tri dana, prijave koje stignu nakon ovog roka, a nepotpune će uopšte ne uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor. U slučaju potrebe za dodatnim informacijama, možete nas kontaktirati na, tel: 038/603-191 od 08:00 - 15:00 časova.

**Uslovi učešća na konkursu:**

Svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, imaju neophodnu obrazovnu spremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i koji imaju pravo da konkurišu imaju pravo da se prijave. fizičke veštine potrebne za odgovarajuću poziciju.

KRM "Pastrimi" dd nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

**Uz prijavu je potrebno priložiti potrebnu dokumentaciju:**

- CV (biografija);

REPUBLIC OF KOSOVO

**Case No 253/2012**

**BASIC COURT OF PRISHTINA -** General Department, Civil Division, with judge Shpresa Veselaj, in the dispute between the Plaintiff Agron Gashi from Prishtina, 24 Xhemajl Ibishi Str., who according to the authorization is represented by Agron Selimaj, lawyer from Prishtina; against the Defendant Branislav (Vitomir) Popovic from the last place of residence Obiliq, former M. Tita Str., no. 156, now with unknown address, with the subject of the dispute being ownership verification, deciding according to the Plaintiff's proposal for the appointment of the temporary representative for the defendant, outside the court session on 13.04.2023, made this:

**RULING**

